

KËRKESË
Nr. 639, datë 17.1.2020

PËR PUBLIKIMIN E FTESËS PËR OFERTË PËR PROCESIN KONKURRUES
“PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTIT QË DO TË PËRFITOJË MASAT
MBËSHTETËSE PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË ZONËN E
KARAVASTASË”

Bazuar në vendimin nr. 349, datë 12.6.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall këtë ftesë për ofertë, për procesin konkurrues për përzgjedhjen e ofertuesit për zhvillimin e projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik në zonën e Karavastasë.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
FTESË PËR OFERTË

1. **Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë, adresa: Rruga “Abdi Toptani”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

2. **Emri dhe adresa e personit të kontaktit:** Z. Antonio Bushati, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

E-mail: antonio.bushati@infrastruktura.gov.al.

Për dijeni: gjergji.simaku@infrastruktura.gov.al.

3. **Forma, objekti dhe lloji i kontraktimit:** Përzgjedhja e ofertuesit për projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një impianti fotovoltaik për gjenerimin e energjisë elektrike, në zonën Remas-Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me një kapacitet të instaluar 70 mw, si pjesë e masave mbështetëse, dhe me një kapacitet shtesë të instaluar prej 70 mw, i cili nuk do të jetë pjesë e masave mbështetëse (gjithsej 140 mw e kapacitetit të instaluar) (projekti).

4. **Lloji i procesit konkurrues:** Procedurë e hapur.

5. **Vendndodhja e projektit:** Impianti fotovoltaik do të ketë vendndodhjen në Zonën e Karavastasë, Remas–Karavasta, Lushnjë, Libofshë, Fier, Shqipëri.

6. **Kohëzgjatja e Marrëveshjes së Zhvillimit të Projektit:** 30 vjet (sipas specifikimeve të parashikuara në dokumentet e procesit konkurrues).

7. **Marrëveshja e blerjes së energjisë elektrike:** Si pjesë e masave mbështetëse, marrëveshja për blerjen e energjisë elektrike do të nënshkruhet për një kapacitet blerjeje 70 mw, për një afat prej 15 vjetësh.

8. **Afati për dorëzimin e ofertave:** 16 mars 2020, ora 12:00 (ora e Evropës Qendrore).

9. **Hapja e ofertave:** 16 mars 2020, ora 12:00 (ora e Evropës Qendrore).

10. **Periudha e vlefshmërisë së ofertës:** Ofertat duhet të jenë të vlefshme për një periudhë 180 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

11. **Sigurimi i ofertës:** Garancia e ofertës, në shumën prej 560,000 eurosh (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë euro), e lëshuar nga një bankë me reputacion, duhet të jetë e vlefshme për një periudhë prej 180 ditësh nga afati për dorëzimin e ofertave.

12. **Blerja e dokumenteve të procesit konkurrues:** Dokumentet e procesit konkurrues mund të blihen duke filluar nga data 20 janar 2020, kundrejt pagesës prej 2,000 eurosh (dy mijë euro).

13. **Pranimi dhe vlerësimi i ofertës:** Sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

Informacion shtesë mbi dokumentet e procesit konkurrues mund të gjeni në *website*-in e autoritetit kontraktues: <http://infrastruktura.gov.al>.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Viola Haxhiademi